

**PHILOSOPHICAL AND PEDAGOGICAL THOUGHTS IN THE  
WORKS OF THE TWO REVIVALISTS REXHEP VOKA AND JOSIF  
BAGERI**

**MENDIMET FILOZOFIKE DHE PEDAGOGJIKE NË VEPRAT E DY  
RILINDËSVE REXHEP VOKA DHE JOSIF BAGERI**

**Arbana AJDINI<sup>1</sup>**

<sup>1</sup> *Department of Albanian Language and Literature, Faculty of Philology, University of Tetova*

<sup>\*</sup> *Corresponding author e-mail: arbana.ajdini@unite.edu.mk*

---

**Përmbledhje**

Rexhep Voka si një filozof dhe pedagog i njohur, me një mjeshtëri të lartë letrare arriti të zhvillojë ide të jashtëzakonshme filozofike, sidomos në lidhje me natyrën e përvojës njerëzore dhe veprimet morale. Theks të veçantë në krijimet e tij kishin vlerat e arsimit të fëmijëve shqiptar, dhe njëherit ndikoi në ndezjen e shpirtit patriotik te shqiptarët dhe arriti të promovonte vlerat kombëtare dhe kulturore. Rilindësi Josif Bageri ishte ndër intelektualët më të shquar që kontribuoi në sferën filozofike dhe pedagogjike. Kontributi i tij ndikoi në edukimin dhe zhvillimin e njeriut në aspektin moral dhe intelektual. Rëndësi për këtë rilindës ishte kultivimi i vlerave morale dhe etike në arsimimin e të rinjve.

Rexhep Voka dhe Josif Bageri, ishin dy figura shumë të rëndësishme të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, pasi intelektu i tyre u shqua në kohën kur jetuan dhe vepruan. Mendimi filozofik dhe pedagogjik i tyre u përkthye në frymëzim dhe ndihmë për të rinjtë shqiptarë duke ndikuar në zhvillimin e tyre dhe njëherit duke i përgatitur ata në zhvillimin dhe modernizimin e shoqërisë shqiptare, dhe njëherit për ti kapërcyer të gjitha vështirësitë e jetës me cilat shqiptarët përballeshin në atë kohë.

**Fjalët kyçe:** Rexhep Voka, Josif Bageri, iluminizmi, humanizmi, Rilindja Kombëtare,, filozofia pedagogjia-arsimore, vlerat historike letrare e kombëtare.

---

Në letërsinë shqipe mendimi filozofik lirisht mund të themi se daton që në kohën e humanizmit shqiptar, që më pas është bartë te shkrimtarët e letërsisë së vjetër shqiptare. Në fillim të shek. XX në periudhën e Rilindjes Kombëtare Shqiptare dy intelektual shqiptarë që kontribuuan në sferën filozofike dhe pedagogjike në hapësirat ku jetonin dhe vepronin shqiptarët e Maqedonisë ishin Rexhep Voka dhe Josif Bageri. Zhvillimi i kulturës letrare te shqiptarët e Maqedonisë pati një rrugëtim të vështirë, duke pasur parasysh rrethanat historike në të cilat u zhvillua. Rrugëtimi i letërsisë shqipe u zhvillua përmes dy horizonteve që njëkohësisht përballeshin e me njëri tjetrin ku jeta dhe vdekja ishin përballë njëra tjetrës.

Poetikën filozofike Rexhep Voka e gjen në konstantën shpirtërore të popullit. Ky krijues në letrat shqipe të kësaj ane, erdhi si imperativ i kohës. Ardhja e tij ruajti ritmin e traditës kulturore e gjuhësore, historike dhe asaj që quhet kombëtare edhe në këtë krah kombëtar. Ishte koha e etapave të vështira historike, sunduesit vinin e shkonin e populli mbetej në vend, por, plagët e vjetra bëheshin të reja, të cilat edhe sot e kësaj dite nuk janë shëruar plotësisht.

Shërimin e këtyre plagëve historike, Voka e shihte se vetëm me ngritjen kulturore e arsimore të brezave të rinj, veçmas fëmijëve do të shpëtojnë nga të gjithë sunduesit:

**“Lipet edhe kalem e këndim.  
Fjalë e mendim”.<sup>1</sup>**

Rexhep Voka njihet si poet e publicist, mësues e profesor, si dhe ligjërues në institucionet fetare të asaj kohe, ku me punë e përkushtim arriti që të depërtojë në problematikat e jetës shqiptare. Rrethanat historike nëpër të cilat kalonte populli ynë, ndikuan në angazhimin e këtij rilindësi që u bë imperativ i kohës, ku bashkë me popullin do arrinin që të ruanin traditën e kulturën gjuhësore, që ishte problemi kryesor shkollimi dhe emancipimi i shoqërisë shqiptare. Puna pedagogjike e Rexhep Vokës për bazë kishte arsimimin dhe edukimin e fëmijëve. Abetarja *Elifbaja shqipe*, e shkruar nga R.Voka, është një dedikim për fëmijët shqiptarë. Në faqen e parë të kësaj abetareje kemi një parathënie dedikuar lexuesit shqiptarë: *Popullit të zgjuat shqiptar që fëmijët e tij të mund të lexojnë e të shkruajnë në gjuhën amtare.*<sup>2</sup>

Bota e fëmijëve ka qenë një preokupim i madh, andaj prej këtij citati kuptohet qartë se autori preokupim e ka botën e fëmijëve shqiptarë. Me të gjitha forcat e veta u mundua që të krijoj kushte e mundësi që ato të mund të shkruajnë e lexojnë në gjuhën shqipe, pasi më lehtë do t’i përvetësojnë njohuritë e reja e të domosdoshme, siç është shkrim-leximi e të tjera. Brenga e Vokës ishte fati i rrjedhës së gjuhës shqipe dhe fati i edukimit dhe shkollimi i fëmijëve. Me këtë vepër synon që fëmijët të mësojnë *abece* shqipe, e cila do ju hap rrugë në përparimin sa më të shpejtë arsimor, edukativ e kulturor, etj.

Rexhep Voka në veprën *Elifbaja shqipe* me një entuziazëm të madh paralajmëron lindjen e një etape të re në hapësirat ku jetonin dhe vepronin shqiptarët në Maqedoni, një rilindje me frymë të re që do ti çonte shqiptarët drejt zgjimit kombëtar. Ky zgjim kombëtar do ti shpëtonte shqiptarët nga kthetrat e sunduesve të huaj, për të vazhduar më tej me zhvillimin e arsimit dhe emancipimin e shoqërisë. Kontributi i Rexhep Vokës në fushën pedagogjike ishte i jashtëzakonshëm, pasi puna e tij u përqendrua në krijimin e sistemit arsimor që fëmijët shqiptar të përparonin në thithjen e dijes, dhe për të kuptuar se bota e civilizuar kishte përparuar me shpejtësi.

Kjo Rilindje Kombëtare shprehjen e vet të fuqishme e gjeti më tepër në letërsi, me të cilën eci krahas edhe letërsia për fëmijë dhe ajo për të rritur. Përfaqësuesit kryesor të kësaj letërsie, njëherësh janë edhe bartësit kryesorë të ideve iluministe, të ndjenjës kombëtare, krenarisë sonë dhe njëkohësisht nxitës për një luftë të gjithëmbarshme kulturore kombëtare në tërësi. Prandaj, mund të themi se ideja demokratike dhe karakteri popullor i sajë, me një optimizëm të madh ngelën karakteristikat thelbësore të kësaj letërsie, e cila esencialisht fare nuk dallon nga letërsia shqiptare të Rilindjes Kombëtare në tërësi.<sup>3</sup>

Libri *Mendime* i Rexhep Vokës, është si një manifest ku shkrihen pikëpamjet filozofike, pedagogjike, fetare e kulturore në tërësi që i përkasin një periudhe të caktuar kohore. Në këtë libër kemi edhe moralizimin e parimeve të shenjta që kanë të bëjnë me virtytet njerëzore, me dashurinë për fenë, dijen dhe popullin në tërësi, veçmas për fëmijët që padyshim janë lumturia, ideali dhe gëzimi i popullit.

<sup>1</sup>R.Voka, *Mendime*, Tetovë, 1991, fq.9

<sup>2</sup>Jehona, Shkup, 1968, nr.2, fq.95

<sup>3</sup>Ajdini E., "Ekskomunikimi kulturor dhe letrar te shqiptarët e Maqedonisë", Tetovë, 1999, f.40

Vepra *Mendime* është e dashur dhe e kuptueshme për të gjitha shtresat e shoqërisë që e lexojnë, dhe e ruajnë aktualitetin e saj për të gjitha kohërat. Ajo, sa është prozë, aq është edhe poezi, sa është për fëmijë, po aq është edhe për të rritur, sa letrare aq filozofike, sa predikim fetar aq edhe traktat sociologjik, sa filozofike aq edhe politike. Poeti qan hallin e njerëzve të devotshëm që tërë jetën i'a kushtonin popullit e atdheut, por të njëjtët tradhtoheshin nga të ligët: *Se ata, burrat dhe të mirët që mundoheshin për atdhenë, dhe mendonin për popullin, njerëzit e ligj i ndiqnin në çdo formë, i mbytyshin me farë e me fëmijë.*<sup>4</sup>

Rexhep Voka sjell formën e re poetike në letërsinë tonë romantike, gjatë gjithë veprës poezia e shpirtit shkrihet në predikimin e filozofit, mësuesit e fetarit, iluministit e patriotit. Duke pasur parasysh pozitën historike të shqiptarëve, si dhe rrethanat në të cilat jetonin, ku me fatin e tyre gjithmonë kanë manipuluar fuqitë e mëdha, zhvillimi i arsimit ishte rruga e vetme e zhvillimit dhe emancipimit të shoqërisë shqiptare. Andaj, Rexhep Voka u angazhua në përhapjen e arsimit në gjuhën amtare, kjo ishte një ndër arsytet ku shprehet se rruga për shpëtimin e shoqërisë shqiptare është shkollimi dhe edukimi i brezave të rinj me një frymë të re, ku ndër të tjera në librin *Mendime* shprehet: *Shkollat t'i hapim edhe në mos paqim mundësi të ndërtojmë ndërtesa të mëdha, në koliba me kashtë fëmijët t'i tubojmë vetëm që të mësojnë.*<sup>5</sup>

Në veprë qartë dëshmohet shpirti poetik e luftarak i humanistit, i të një mendimtari, i cili u përkushtua që në mënyrë sa më origjinale të shfaq ndjeshmërinë e të përkushtuarit të Zotit si dhe përkushtimin ndaj gjendjes së mjerueshme të popullit si në aspektin arsimor por edhe social. Mirëpo, nuk është e lehtë ndarja e poetit nga filozofi apo edhe nga predikuesi fetar, e gjithë kjo mund të merret si një bosht ku njerëzit ta duan fenë por në të njëjtën kohë edhe diturinë: *O burra! O bijë, mirë ta dini./ Se feja e dija. /Janë dy fletë për njerëzinë, /nga Perëndia...*<sup>6</sup>

Rilindësit Rexhep Voka dhe Josif Bageri, me pendën dhe mjeshtërinë e tyre artistike arritën që të depërtojnë në problematikat e jetës shqiptare dhe njëherit të ndërgegjësojnë brezat e rinj. Këto ide iluministe nuk vinin si ide të organizuara e të studiuara si në shtetet perëndimore të Evropës, por ato lindën dhe u zhvilluan si imperativ i kohës, si nevojë e domosdoshme, pasi shpëtimi i kombit shihej vetëm përmes arsimit dhe vetëm me arsimimin e njeriut, që kështu mund të kaloheshin të gjitha problemet dhe prapambetjet kombëtare. Për njeriun që s'mund të mësoj fe e dije s'dallon prej bagëtie, përveçse me hije shkruante R. Voka. Ishte pikërisht ky motiv që kishte trajtuar edhe Naimi te vjersha "Gjuha jonë".<sup>7</sup>

Preokupimi kryesor i tyre ishte emancipimi dhe shkollimi i të rinjve shqiptar që u bë njëherit edhe imperativ i kohës. Andaj, këta rilindës duke parë pozitën e palakmueshme të shqiptarëve, pasi fati i tyre ishte në duart e fuqive të mëdha, e gjithë kjo ndikoi që shkrimtarët shqiptarë të kërkonin që fatin e tyre ta merrnin vet në duart e tyre për të luftuar paditurinë shekullore të popullit, siç edhe shprehet Josif Bageri: *Qindroni vllazën, me bes e trimni, Se detyra jon asht, t'a sqojm kët' Shqypni!...Koha sot ka ardh, lypën ditunii; Me t'cilën diftohet, ajo trimëni!*<sup>8</sup>

Përhapja e arsimit shqip ishte parësor për këta rilindës, me qëllim që të vegjlit të mësojnë gjuhën shqipe nëpër shkolla, gjë e cila do të ndikojë në zhvillimin e kulturës dhe historinë shqiptare. E gjithë kjo për ta ishte një obligim i cili duhet të përmbushet ndaj kombit dhe gjuhës shqipe edhe pse përpara vetes kishin një rrugë e cila ishte e shtruar me gjemba, gjemba të cilët shponin çdo qelizë të indit shqiptarë, vështirësi të shumta që duhej që ti tejkalonin, të dërgonin fëmijët nëpër shkolla dhe njëherit për ta ngritur diturinë, për tu dhënë vlerë krijimeve letrare, historike e kulturore.

<sup>4</sup>Ajdini E., "Ekskomunikimi kulturor dhe letrar te shqiptarët e Maqedonisë", Tetovë, 1999, f.72

<sup>5</sup>Voka R., "Mendime, Tetovë", 1991, f.29

<sup>6</sup>R.Voka, *Mendime*, Tetovë, 1991, fq.10

<sup>7</sup> Ajdini E., "Ekskomunikimi kulturor dhe letrar te shqiptarët e Maqedonisë", Tetovë, 1999, f.44/45

<sup>8</sup>Bageri J., "Reka, Vendiim", Tetovë, 1995, f.21

Përpjekjet dhe peripecitë e tyre nuk shkuan dëm, pasi arritën që të bashkojnë indet e shkëputura të trungut shqiptarë në aspektin arsimor, kulturor e historik, ky vështrim shihet qartë në poezitë e Bageri te përmbledhja poetike “Reka, Vendi im”: *Kish kjon mbarre me mohue, Gjuhën e vet natyrale!...T’cilën na s’keni harrue, Po e kemi msu në male.*<sup>9</sup>

Dëshira dhe vullneti i gjithanshëm i rilindësve, bën të mundur që të tejkalohen vështirësitë me të cilat përballëj populli shqiptar, andaj, ata me një përkushtim të jashtëzakonshëm të bëjnë hapjen e shkollave shqipe, klube, të botojnë revista, që ndikoi në zhvillimin kulturor. Shqiptarët me një mjeshtëri të lartë e ruajtën unitetin shpirtëror, duke i mbledhur forcat ata arritën që t’i kundërvihen politikës së egër asimiluese. Këtë unitet, rilindësit e kësaj toke u munduan që përmes krijimeve letrare, t’i përcjellin idetë e tyre drejtë gjeneratave të reja, veçmas në botën e të rinjve, siç ishte dëshira për atdheun, gjuhën, traditat etj, Josif Bageri do të shprehet se: ***Emni yt s’harrohet dot, n’istorit të Shqypnis, të falim nderit sot për sot, për trininë e djelmënisë.***<sup>10</sup>

Mirëpo, përmes krijimeve të tyre artistike këta rilindës shpalosën botën e egër në të cilën jetonin shqiptarët që ishte hermetikisht e mbyllur si dhe realitetin jetësor në të cilin jetonin. Përpjekjet e tyre nuk shkuan dëm, pasi ata arritën që të shfaqnin rrënjët e qytetërimit tonë të lashtë që kishte kohë që ishin të shkëputura nga qenia jonë njerëzore, dhe njëherit duke i hapur rrugë perspektivave të reja për gjeneratat e ardhshme.

## Referencat

- [1]. Ajdin E., ”Ekskomunikimi kulturor dhe letrar te shqiptarët e Maqedonisë”,Tetovë,1999
- [2]. Bageri J., “Reka,vendi im”,Tetovë,1995
- [3]. Bexheti V.,”Rexhep Voka dhe vepra e tij 1847-1917”,Tetovë,2001
- [4]. Kraja M.,”Mësuesit për kombin shqiptar”,Tiranë,1993
- [5]. Mustafa A., “Figura mësuesish shqiptarë”,Tetovë,1995
- [6]. Sinadinovski B., “Josif Bageri,rilindasi,poeti dhe publicist i madh shqiptar”,Shkup,2013
- [7]. Voka R.,”Mendime”,Tetovë,1991.

---

<sup>9</sup>Bageri J., „Reka, Vendi im”, Tetovë, 1995,f.20

<sup>10</sup>Bageri J.,”Reka,vendi im”,Tetovë,1995,f.82